43.929 m³/sec

Slope ratio (angle)

0.015000 (0.859°)

Calculate water flow rate



[Handwritten signature]



[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

Registered copy: Licensed by www.pipellow.co.uk

Rect. tank | Circular tank | Cylinder | Sphere | Cone (frustum) | Rect. hopper | Flow from Weirs | Manning calculator
 Pipe (part full) | Pipe (full) | Rect. tube (part full) | Rect. tube (full) | Rect. channel | Flat bottom channel | Vee channel

Section details

Metric Imperial

Manning's coefficient

0.020 Cement rubble

Length in metres

100.000 m

Internal height

* 1100 mm

Internal width

* 10000.000 mm

Left bank width

* 2200 mm

Right bank width


* 2200 mm

Fluid depth (uniform flow)

* 790 mm

Drop in metres

1.5 m



* dimensions in mm

Results

- Water flow rate
- Water depth
- Volume and weight
- Length expansion

Fluid cross section area 9.148200 m² Fluid velocity 4.717 m/s

Wetted perimeter 13532.987 mm Fluid surface width 13160.000 mm

Hydraulic radius 675.993 mm Froude number 1.807 - rapid flow

Water flow rate 43.151 m³/sec

Calculate water flow rate Slope ratio (angle) 0.015000 (0.859°)



Pipe Flow Advisor www.pipeflow.co.uk 2013-11-07

Registered copy. Licensed by www.pipeflow.co.uk

Rect. tank | Circular tank | Cylinder | Sphere | Cone (frustum) | Rect. hopper | Flow from Weirs | Manning calculator
 Pipe (part full) | Pipe (full) | Rect. tube (part full) | Rect. tube (full) | Rect. channel | Flat bottom channel | Vee channel

Section details Metric Imperial

Manning's coefficient
 0.020 Cement rubble

Length in metres
 100.000 m

Internal height
 * 1000 mm

Internal width
 * 3200 mm

Left bank width
 * 1500 mm

Right bank width
 * 1500 mm

Fluid depth (uniform flow)
 * 740 mm

Drop in metres
 6.75 m

Increase
 Reduce

Results

Water flow rate
 Water depth
 Volume and weight
 Length expansion

Fluid cross section area
 3.189400 m²

Fluid velocity
 8.652 m/s

Wetted perimeter
 5868.108 mm

Fluid surface width
 5420.000 mm

Hydraulic radius
 543.514 mm

Froude number
 3.602 - rapid flow

Water flow rate
 27.594 m³/sec

Slope ratio (angle)
 0.067500 (3.862°)

Calculate water flow rate

* dimensions in mm

Pra sic del ne te dy rastet del e nevojshme shpejtesia eshte nen 8 m/sek, prandaj mund te pranojme tabanit dhe skarpatat te vishen me betonsi dhe zhytjes se gureve ne beton.

5.2- VEPRAT E ARTIT

Bazuar ne gjendjen ekzistuese te veprave ta artit ne perrua, u pranua qe kaskadat te riparohen duke u cuar dimensionet ne kushte te tilla qe ne to te kalojne prurjet me siguri 1 %.

6.- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1.-Rehabilitimi i ketij segmenti te peroit te Voskopit ne zonen e banuar te Qendres se Komunes se Voskopit eshte domosdoshmeri, mbi bazen e kushteve aktuale dhe rritjen e vazhdueshme te turizmit malor sidomos atij familjar ne te ardhmen.




- 2.-Rikonstruksioni te realizohet duke u shmangur sa me pak te jete e mundur nga aksi ekzistues i perroit.
- 3.-Gjeresia e perroit se bashku me bankinat te mos kaloje 16 metra, ndersap gjeresia te rruhet ajo ekzistuesja prej 1.5-2.2 %.
- 4.-Trashesia e veshjes prej betonite jete 25 cm.
- 5.-Per rritjen e ashpersise ,per rrjedhim uljen e shpejtesise, ne shtresen e betonit te zhyten gure ,duke i lene jashte tij rreth 10-20 cm.
- 6.-Anash perroit, ne te dy krahet te parashikohen rruge.

H A R T O I

Ing.Koco SHEDOLLARI

Ing. Ilia KERENXHI

SPECIFIKIME TEKNIKE
Perroi Voskop



SPECIFIKIME TEKNIKE

Rrjeti Shperndares perroi Voskop Fshati VOSKOP Komuna VOSKOP, Qarku Korce

Ndertimi i perroi te fshatit Voskop.

Te pergjitheshme.

Pergatitja e ketij kapitulli behet me qellim per te sqaruar kerkesat e projektit per kontraktorin ne lidhje me respektimin e kushteve teknike te zbatimit, kontrates, legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen e punonjesve, te ambientit dhe publikut si dhe detyrimeve qe duhet te plotesoje kontraktori gjate zbatimit te punimeve.

Njohja me dokumentacionin

Vizatimet dhe dokumentacioni teknik qe shoqerojne kete projekt do te jene baze per vleresimin e sasise dhe cilesise se punes qe do te behet per zbatimin e ketij projekti.

Kontraktori duhet te jete njohur me projektin qe ne fillim te punes dhe perpara lidhjes se kontrates me investitorin. Kontraktori do te verifikoje te gjitha sasite, permasat, te dhenat teknike dhe detajet e dhena ne vizatimet dhe dokumentat e tjera qe shoqerojne kete projekt.

Kontraktori do te marre persiper te gjithe pergjegjesine ne kryerjen e llogaritjeve per sasine dhe llojet e materialeve, volumeve te punes si dhe pajisjeve te kerkuara per realizimin e ketij projekti.

Ndryshimet ne projekt propozohen tek supervizioni dhe ai ne bashkepunim me

117

projektuesin dhe miratim te investitorit ben miratimin e tyre.

Publikimi i projektit.

Kontraktori qe para fillimit te punimeve duhet te beje prezantimin e projektit ne publik nepermjet presantimit te parametrave kryesore te investimit ne nje table metalike me permasat 2 x 1 m. Parametrat kryesore jepen permes emrit te objektit, vleren e tij, fillimin dhe perfundimin e punimeve, punedhenesin, kontraktorin, supervizorin e punimeve, etj.

Forma dhe menyra e paraqitjes do te aprovohen nga punedhenesi. Tabela e punimeve duhet te vendoset ne nje vend te dukshem prane sheshit te ndertimit ne bashkepunim me supervizorin dhe punedhenesin.

Rekomandime

Ne vartesi te gjendjes ekzistuese te rrjetit ekzistues apo detyrave te zgjidhura nga projekti, ndertimi i Perroit te Voskopit fillon nga:

- 1- germimit dhe sistemimit te perroit.
- 2- veshja me beton e tij
- 3.-ndertimi i dy tombinove
- 4.-ndertimi I dy barazhave per ujitje

Kontraktori duhet te kete parasysh mundesine e venies ne pune te perroit ne menyre integrale dhe jo pjesore ne menyre qe te shmangen avarite apo demtimet e mundshme.

Finalizimi i punimeve nenkupton; perfundimin komplet te veshjes me beton ,ndertimin e dy tombinove dhe dy port-barazheve.

1- Seksioni i veshjes me beton.

1.1 Seksioni

Perroi do te vishet me beton ne te gjitha gjatesine e tij me beton te markes M-200



1.2 Dokumentacioni teknik shoqerues.

Cimentoja si dhe inertet dhe uji qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te jene te certifikuar me certifikata te cilesise sipas standarteve shteterore ne fuqi si me poshte :

- Certifikata e Origjines se mallit nga Prodhuesi i cimentos dhe inerteve
- Certifikata e Testimit te cimentos dhe te inerteve

_ Leja Zyrtare per prodhimin e cimentos dhe inerteve

Per perdorimin e tyre duhet te jepen edhe te dhenat e menyres se perdorimit dhe , kontrollit dhe testimit gjate procesit te perdorimit

1.3 Transportimi dhe Magazinimi i materialeve

Transporti i cimentos dhe materialeve inerte duhet te behet nga automjete te pershtatshme per transportin e tyre te cilat duhet te jene te pajisura me mbrojtese anesore me lartesi te pakten $H= 0,6$ m.dhe te mbuluara me mushama.

Ngarkimi dhe shkarkimi i tyre duhet te behet me kujdes

Gjate te gjithë kohes se magazinimit, transportimit te tyre ne objekt dhe derin e momentin e instalimit, materialet mbushese dhe cimentoja duhet te jene te seleksionuar dhe te mbrojtur nga agjentet atmosferike si shiu bora e te tjera.

Zona e magazinimit te cimentos duhet te jete e rrafshet, e paster, pa zhavorre apo gure te mprehte, e rrethuar dhe e mbrojtur. Lartesia e vendosjes se thaseve te cimentos nuk duhet te kaloje tete rrjeshta.

Gjate te gjithë kohes se magazinimit cimentoja duhet te jete e mbrojtur nga efektet e naftes, vajit, solventeve apo substancave te tjera kimike.

Periudha maksimale e magazinimit te cimentos duhet te jete e percaktuar sipas standarteve nga vete prodhuesi. Cimentoja duhet te hiqet nga magazina dhe te zbulohet nga mbulesa e paktimit te tyre ne nje kohe sa me te shkurter para perdorimit te saj

1.4 Materialet per prodhim betonesh.

1.4. Cimento

Pregatitja e betoneve do te behet me cimento qe gjendet ne tregun shqiptar te markes M-200.

Cimento duhet te shperndahet ne paketa orgjinale te shenuara, te pademtuar, direkt nga fabrika dhe te ruajtura ne kushtet e duhura ne nje depo te pershtatshme dhe te ajrosur.

Thaset e cimentos duhet te jene te vendosur te pakten 15 cm mbi sip. e tokes.

Cimento nuk duhet te qendroje me shume se tre muaj ne kantier pa lejen e supervizorit. Cdo lloj cimento e ngurtesuar apo e demtuar nuk duhet te perdoret. Cdo dergese e cimentos duhet te jete e shoqeruar me certifikaten e cilesise dhe flete analizat perkatese te fabrikes prodhuese.

Cimento e perftuar nga pastrimi i thaseve te cimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret.

Supervizori ka te drejte te kerkoje ritestimin e cimentos kur ka dyshime mbi cilesine e saj apo gjendjen aktuale.

1.5. Uji.

Uji qe do te perdoret per prodhimin e betoneve duhet te jete i cilesise te paster pa permbajtje mbetyrinash apo lendesh organike.

Ne te gjitha rastet sasia e ujit qe do te perdoret do te permbudhe raportin uje /cimento ne vartesi te markes te kerkuar.

Nuk duhet te perdoret uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes.

Vetem uje i aprovuar nga ana cielsore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e araturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.



1.6 Inertet.

Inertet per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH - 512 - 78 ose ne perputhje me ASTM C 33

Ato duhet te jene te paster, te forte, te qendrueshem, dhe nuk duhet te permbajne lende organike ose masa te tjera te demshme qe veprojne kunder fortesise dhe qendrueshmerise se betonit.

Materialet e perdorura si inerte duhet te perftohen nga burimet e njohura dhe te licensuara qe sigurojne rezultate te kenaqshme per te gjitha llojet e betoneve.

Inertet e perdorura do te jene te imta dhe te trasha. Ato do te perdoren se bashku ne betonet sipas nje raporti te dhene ne Kushtet Teknike perkatese dhe me aprovimin e Supervziorit te Punimeve.

1.6.1 Rerat.

Materiali i imet (Rerat) qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te jete rere lumi e lare nga materialet organike apo material guri i fraksionuar
Granulometria e pranuar ne vartesi te perdorimit do te jete:

- Per betone me madhesi 0-5mm

1.6.2 Granilet.

Materiali i agregateve qe do te perdoret per prodhim betoni do te jete zall lumi i pastruar ose material guri i fraksionuar me madhesi te kokrizave 10/20mm.

1.7 Pergatitja dhe hedhja e betoneve.

Kontraktori duhet te te ndjeke nga afer procesin e hedhjes dhe ngjeshjes se betonit si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te ciles duhet te jete prodhimi i nje betoni te markes se caktuar ne project.

118

Pasi te jete perziere, betoni duhet te transportohet ne vendin e punes sa me shpejt te jete e mundur, i ngjeshur mire deri sa te krijoje siperfaqe te lemuara, pa vrime dhe pa xhepa ajri.

Betoni duhet te vibrohet me cdo kusht me mjete vibruese per ta bere sa me te dendur dhe aty ku eshte e nevojshme, mjetet vibruese duhet te prodhojne vibrime jo me pak se 5000 cikle ne minute. Vibratoret duhet te vendosen vertikalisht ne beton dhe te terhiqen gradualisht kur flluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe ngjeshjes se betonit duhet te mbahen ne mbikqyrje te vazhdueshme nga pjestaret perkates te ekipit te punes.

Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare por gjithmone jo me vone se 30 minuta pas perzierjes.

Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni nuk duhet te lejohet te formoje skaje apo ane por duhet te ndalohet dhe te forcohet mire ne nje ndalese te ndertuar dhe te formuar posacerisht per te krijuar nje bashkim konstruktiv efikas qe eshte ne pergjithesi drejt armatimit kryesor.

Para se te hidhet betoni tjetër, siperfaqet e te gjitha fugave duhet te kontrollohen, te pastrohen me furce metalike dhe te lahen.

Para se betoni te hidhet ne nje siperfaqe te germuar, ky germim duhet te jete i forcuar dhe pa uje i rrjedhshem apo te ndenjtur, vaj apo lende te tjera te demshme

1.7.1 Provat e betoneve.

Kontraktori duhet te siguroje kryerjen e provave duke siguruar nje set 3 kubikesh per cdo strukture betoni, perfshire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³ duhet te sigurohet nje set shtese 3 kubikesh. Ne se mesatarja e proves se fortesise se kampionit per cdo porcion te punes bie poshte minimumit te



11/10/2022
17:00:47
SHKURER - ALBANIA



lejueshem te fortesise se specifikuar, Supervizori do te udhezaje nje ndryshim ne raportet ose permabjtjen e ujit ne beton ose te dyja ne menyre qe Punedhenesi te mos kete kosto shtese.

Kontraktori duhet te percaktoje te gjithë kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Ne se rezultatet e testeve te fortesise pas kontrollit tregojne se betoni i perftuar nuk ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifikuara, kampioni do te refuzohet nga Supervizori i Punimeve dhe Kontraktori do ta rivendose masen e kthyer mbrapsh me shpenzimet e veta. Kontraktori duhet te mbuloje me shpenzimet e veta te gjitha provat qe do te behen ne nje laborator qe eshte aprovuar nga Punedhensi.

2- Piketimi i objektit.

Para fillimit te punimeve te germimit kontraktori ben piketimin e objektit (aksin e perroit) si dhe percaktimin e kuotave te tij atje ku eshte grafikuar fillimi i punimeve. Pergjate seksionit te perroit duhet te vendosen piketa fikse referuese me kuota referuar sistemit poligonal te ndertuar paraprakisht. Keto pika fikse (referimi) ndertohen me kunjat hekuri te fikesuara ne beton ose ne mure rrethues solide me qellim dhenien dhe kontrollin e pjeretise te shtratit si gjate punimeve te zbatimit si dhe kontrollin e tyre ne se kerkohet nga Supervizioni.

Ne funksion te gjeretise te rruges si dhe rrjetave te tjera inxhinierike vendosja e aksit te perroit do te behet ne baze te planimetrise se percaktuar ne projekt. Gjate piketimit do te behet trasimi i gjurmes te se perroit. Cdo ndryshim i posicionimit te aksit te perroit do te behet me miratimin e supervizionit ne vend.

Kontraktori njofton supervizionin per ditën e piketimit te objektit sipas seksioneve. Gjate zbatimit te punimeve kontraktori duhet te beje ne menyre periodike dhe te

vazhdueshme, fotografime te punes sipas udhezimeve te supervisorit ne menyre qe te demostroje progresin e punes, cilesine e materialeve te perdorura dhe punimeve te kryera, kushtet e punes, etj.

3- Punime Germimi

Germimi per celjen e seksionit te perroit do te behet me gjeresine sipas prerjes te dhene ne projekt. Gjeresia minimale e hapjes te perroit duhet te siguroje punen e ekskavatorit (sipas gjeresise se koves)

Thellesia e germimit do te jete sa ajo ne projekt mbi 1m nga siperfaqja e tokes. Depositimi i dherave qe dalin nga germimi mund te depozitohen anash seksionit te germuar por gjithmine jo me pak se 60 cm lagesi nga seksioni i hapur. Teniku duhet te llogarise sasine e dherave qe duhet te largoje si rezultat i volumit teper .

4- Pregatitje e shtratit te perroit

Tabani I perroit duhet te jete I qendrueshem, ne menyre qe te garantohet hedhja e betonit.

Pregatitja e shtratit do te behet mbas largimit te materialit te germuar dhe llumit ne tabanin e haput te kanalit duke bere nivelimin dhe ngjeshjen e tij.

5- Sistemi i aneve te perroit.

Mbas shtrimit dhe betonimit te shtratit te perroit menjehere behet sistemimi I kraheve te skarpatave te peseksionit te perroit. Si material mbushes mund te perdoren materialet e dala gjate germimit ne se jane te pershtateshme per tu perdorur ne vartesi te lageshtise si dhe te materialeve te ngurta ne te. Nuk lejohet prezenca e gureve apo sendeve te forta me madhesi me te madhe se 75cm. Mbushja behet me shtresa duke bere njekohesisht dhe kompaktesimin e saj Ne shtresen e siperme te seksionit perdoret rreth 15 cm material i fraksionuar mbushes me granulometri 0 deri ne 22mm.

7- Mbrojtja e punimeve, ambjentit dhe publikut



Kontraktori duhet te marre te gjitha masat e duhura paraprake per mbrojtjen e puntoreve, publikut si dhe pasurive ne dhe perreth sheshit te ndertimit konform ligjeve ne fuqi. Ai eshte pergjegjes i vetem per respektimin e masave te sigurimit teknik, kodeve te ndertesave dhe ndertimeve te tjera duke perfshire edhe ato arkeologjike, muzeale dhe historike. Kontraktori duhet te beje sigurimin e jetes se punonjesve te saj, makinerive dhe punimeve prane njeres prej shoqerive te Sigurimit qe veprojne ne Shqiperi.

Gjate zbatimit te punimeve, Kontraktori me shpenzimet e veta duhet te vendose dhe te mirembaje gjate nates pengesa te ndryshme dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidente te mundshme qe lidhen me keto punime. Kontraktori duhet te siguroje pengesa te pershtatshme, shenja me drita te kuqe "rrezik" ose "Kujdes" si dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te levizjes normale te mjeteve ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

Kontraktori, me shpenzimet e veta duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundshme per te siguruar ruajtjen e ambientit lokal nga ndotjet e ndryshme gjate punes, nga zhurmat, nga demtimet e pemeve, etj. Per kete arsye, te gjitha makinerite dhe pajisjet qe do te operojne ne terren duhet te jene te pastra, te pershtatshme per transportin e materialeve pa shkaktuar derdhjen e tyre dhe konform rregullave dhe kushteve teknike te levizjes se tyre.

Mosplotesimi i kushteve te mesiperme apo mospajisja me leje perkatese te qarkullimit te mjeteve mund te sjelle edhe nderprerjen e Kontrates.

Kontraktori, me shpenzimet e veta duhet beje te gjitha riparimet e defekteve te shkaktuara ne rrjetat ekzistuese si ujesjelles, telefoni, elektrik etj, per funksionimin normal te jetes ne qendren e banuar.

Ing. Koco Shedollari

121

SPECIFIKIMI I CMIMEVE

**PER OBJEKTIN : SISTEMIM PERROIT TE MADH QENDER FSHATI
VOSKOP) SI DHE SISTEMIMI RRUGEVE ANASH PERROIT**

Nr 1 PUNIME GERMIMI

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te forte e te zakoneshme me makineri dhe 10 % me krahe, ngarkimi me automjet dhe largimi I tij ne distance deri 1 km.

Nr 2 MUR GURI MBAJTES LLB M 30

a) Ne punimin e germimit eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te forte e te zakoneshme me krahe, dhe largimi I tij ne distance deri 30 ml.

b) Ne ndertimin e mureve eshte parashikuar ndertimi mureve mbajtes e prites me llac bast m 30. Guret do te perdoren nga formacioni material vendi dhe eshte parashikuar te merren ne afersi me nje distance transporti 1 km. Llaci do te jete me pluhur guri ose rere e lare qe te realizohet marka e llacit 30 simbas normativave te KTZ ne fuqi. Vlefte e materialit dhe transportit eshte parashikuar vecmas me shpenzimet per pagesat puntori dhe me shtesat perkatese

c) Ne ndertimin e kapucit te betonit mbi mur eshte parashikuar vlefte e betonit e pregatitur ne vend dhe betonimi I kapucit simbas dimesioneve te dhena ne projekt. Jane parashikuar kallepet e ndryshem per realizimin simbas projektit, vlefte e kallepeve dhe materialeve te tjera ndihmes, gozhde etj. Pervec kesaj eshte parashikuar vlefte e nevojeshme e fuqise puntore qe nevojitet per montimin e zmontimin e kallepeve si dhe nivelimin e ngjeshen e betonit me gjithe shtesat mbi page per sigurimet shoqerore, fitim etj.

Nr 3 PUNIME SHTRRESASH PER RRUGET



- a) Shtrese cakelli 15 cm dhe 20 cm.

Parashikon shpenzimet ne teresi per realizimin e 1 m² shtrese. Ne cmim perfshihen marrja e materialit cakell rifjuto nga gurorja, cmimi i vete cakellit, ngarkimi ne automjet veteshkarkues, transporti ne object shkarkimi e shperndarja e tij simbas projektit, duke patur parasysh edhe profilimin. Ngjeshja e tij duhet te behet ne gjendje te njome. Materiali duhet te jete me madhesi 0 deri 35 mm me nje perqindje der 15 % argjile. Ngjeshja realizohet me rul te rende. Ketu eshte parashikuar edhe perpunim me krah i siperfaqes. Ne vleften e fuqise puntore jane edhe sigurimet shoqerore.

- b) Shtrese stabilizanti 10 cm + sperkatje me bitum.

Ne kete process pune eshte parashikuar vlefta e cakellit te paster, transporti i tij me makine veteshkarkuese, perhapja e tij nivelimi me krah si dhe sperkatja me 4 litra bitum naftanik per 1 m². Perfshihen pagat puntori, shtesat per sigurime shoqerore si dhe cilindrimi i siperfaqes.

- c) Shtrese binderi t= 5 cm

Ne kete process pune jane parashikuar cmimi ne fabrike i binderit, transporti i tij dhe shtrimi i tij me makine asfaltoshtruse. Eshte perfshire edhe sperkatje me bitum para shtrimit. Ne cmim eshte parashikuar edhe shpenzimet puntori me gjithë shtesat si sigurime shoqerore etj. Po keshtu eshte vendosur edhe shpenzimet per cilindrimin gjithnje duke respektuar K T Z per keto loj punimesh.

- d) Shtrese asfaltobetoni t= 4 cm

Ne kete ze cmimi eshte parashikuar vlefta kryesore e asfaltobetonit per 1 m² ne baze te sasise qe i takon simbas normativave te materialit ne perputhje me manualin e hartuar per ket rast. Pervec vleftes si material jane parashikuar transporti nga nyja ne veper, perhapja me makine asfaltoshtruse simbas projektit dhe rulimi i tij ne baze te K T Z per punimet e asfaltimit. Eshte parashikuar edhe fuqia puntore e nevojeshme pagat e shtesat.

- e) Shtrese cakelli makinerie te imet 10 cm

Parashikon shpenzimet ne teresi per realizimin e 1 m² shtrese. Ne cmim perfshihen marrja e materialit cakell makinerie nga gurorja, cmimi I vete cakellit, ngarkimi ne automjet veteshkarkues, transporti ne objekt shkarkimi e shperndarja e tij simbas projektit, duke patur parasysh edhe profilimin dhe ngjeshja e tij. Ngjeshja realizohet me rul te rende. Ketu eshte parashikuar edhe perpunim me krah I siperfaqes. Ne vleften e fuqise puntore jane edhe sigurimet shoqerore.

Nr 4 PUNIME NE TROTUAR DHE BORDURA

F V ordure rruge 14x25 PF

Jane parashikuar vlera e bordurave transporti I tyre ne objekt, pregatitjen e vendit ku do te vendosen, nivelimi terrenit si dhe shtresa e llacit ku vendosen. Jane parashikuar materialet dhe pagat e nevojeshme per ta perfunduar te gjithe punen se bashku me shtesat e tjera si sigurime shoqerore etj.

b) Trotuar me pllaka veteshtrenguese t=6 cm

Jane parashikuar si edhe ne rastin e pllakave decorative shpenzimet materiale dhe pagat puntori. Ketu nuk jane perfshire nenshtresat me rere e zhavorrr

c) Shtrese rere t= 6 cm

Perfshin cmimin e reres, transportin e saj dhe shtrimin e saj sipas procesit te punes. Ketu eshte future edhe pagat per perpunimin e saj, transportin e shperndarjen me gjithe shpenzimet mbi paga per sigurimet shoqerore dhe fitimin.

d) Shtrese zhavorri 10 cm

Ne cmim eshte perfshire cmimi I zhavorrit, transporti I tij eri ne vendin e punimeve, dhe shperndarja e tij sipas projektit duke patur parasysh pagat puntori e shtesat mbi paga.

e) FV kuneta betoni PF C 16/20

Eshte parashikuar qe pllakat (elementet e gateshem) me vleren e tyre te parapregatitur te sillen ne vendin e punes dhe te montohen ashtu si jane parashikuar e dhene ne projekt. Ne kete



Handwritten signature in blue ink.



rast jane parashikuar vlera e llacit per nivelimin e tyre si dhe te fuqise puntore se bashku me shtesat dhe fitimin e planifikuar.

f) F V Bordura trotuari 12x25 PF

Si edhe ne zerin e bordurave te rruges parashikohet furnizimi I tyre ne objekt e pregatitja e vendit e vendosja e tyre se bashku me shpenzimet e tjera ne fuqi puntore me te gjitha shtesat e fitimin

Nr 5 PUNIME PER KUZ DHE TE SHIUT NE RRUGE

a) Punime germimi kanal, e puseta

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te forte me krahe, ngarkimi me automjet dhe largimi I tij ne distance deri 1 km

b) Shtrese rere per vendosjen e tubove

Perfshin cmimin e reres, transportin e saj dhe shtrimin e saj sipas procesit te punes. Ketu eshte future edhe pagat per perpunimin e saj, transportin e shperndarjen me gjithe shpenzimet mbi paga per sigurimet shoqerore he fitimin.

c) F V tubo korrogato PVC Dn 200 dhe 300 mm

Eshte parashikuar ,pervec germimit, pregatitja e vendit, sjellja ne objekt e tubove, vendosja e tyre lidhja me pusetat. Jane parashikuar vlera e nevojeshme e puntoreve e specialisteve se bashku me shtesat per sigurimet shoqerore si dhe fitimi I planifikuar.

d) Mbulim tubacioni

Ne kete ze pune jane parashikuar vetem shpenzimet e pune ne paga puntori me gjithe shtesat per mbulimin, ngjeshjen e nivelimin me dhe te kanaleve me tubacione si dhe nivelimin e tyre.

e) Ndertim puseta shiu me zgare gize

Ne kete ze jane parashikuar te gjithe punimet e nevojeshme per realizimin e pusetes. Germimi , materialet e nevojeshme sipas projektit, transporti I tyre si dhe fuqia puntore specialiste e

puntore te thjeshte. Jane patur parasysh shpenzimet per sigurimet shoqerore etj si dhe fitimi planifikuar 10 %.

f) Ndertim puseta kontrolli

Eshte parashikuar germimi dheut, largimi I tij dhe ndertimi I pusetes me te gjitha detajet e paraqitura duke patur parasysh te gjitha shpenzimet materiale e te fuqise puntore me shtesat si dhe fitimin e planifikuar

Nr 6 PUNIME ELEKTRIKE

a) Punime germimi per shtylla e tuba elektrike

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te forte me krahe, ngarkimi me automjet dhe largimi I tij ne distance deri 1 km

b) F V shtylla elektrike kandelabra ne trotuare h 8 m

Jane parashikuar vlera e shtyllave, ndricuesave me te gjithe aksesoret, transporti I tyre ne objekt si dhe montimi I tyre si hapja e bazamentit e fiksimi. Kabllot jane parashikuar ne ze te vecante. Per montimin eshte parashikuar makineria e nevojeshme edhe fuqia puntore me te gjitha shtesat mbi pagen per sigurime shoqerore se bashku me fitimin e planifikuar per nje cope.

c) F V kuti plastike 20x20 cm

Eshre parashikuar vlera e kutive, sjellja e tyre ne objekt dhe montimi I tyre sipas projektit per nje cope. Ne cmim eshte parashikuar ehe vlera e fuqise puntore per venosjen e tyre se bashku me shtesat

d) F V tubo plastike Dn 100

Cmimi perfshin vleften e tobove, transportin ne venin e caktuar sipas projektit, hapjen e kanalit, montimin dhe mbulimin e kanalit sipas kushteve teknike. Ne cmim eshte parashikuar vlera e nevojeshme ne fuqi puntore se bashku me shtesat dhe fitimin

e) F V kabl elektrik 4x6 mm

Eshte patur parasysh ne cmim vlera e kabllit, shpenzimet per transportin ne object si dhe pagat (me gjithe shtesat



e fitimin) e nevojeshme per shtrimin e lihjen me burimin e rrymes te ndricuesave e te kuadrit komandues) qe te realizohet funksionimi I ndricimit te planifikuar.

f) Shufra tokezimi xingato

Eshte parashikuar vlera eshiritit metalik xingato 40x6 mm shtrirja e tij ne toke saldimi i tij e lidhja metoken simbas KTZ ne fuqi.

Nr 7 PUNIME GJELBERIMI

a) Mbjellje peme dekorative.

Ne cmim eshte parashikuar vlera e fidaneve, transporti e sjellja e tyre ne object, hapja e gropes, vendosja e fidanit e mbushja me dhe, ku jane parashikuar pagat e nevojeshme per kryerjen e punes me shtesat e tjera sigurime shoqerore e fitim. F V bordure min peme PF.

Parashikon furnizimin, transportin e vendsjen me nivel te tyre. Jane parashikuar materialet, transporti si dhe paga me gjithë shtesa e fitimin per te perfunduar punen.

Mbjellje sipërfaqe me bar dekorativ lolium.

Parashikon punimin e tokes, transportin e furnizimin me fare bari si dhe mbjelljen e vaditjen. Jane parashikuar materialet, transporti si dhe paga me gjithë shtesa e fitimin per te perfunduar punen.

Mbjellje shkurre dekorative.

Parashikon punimin e tokes, transportin e furnizimin me shkurret dekorative si dhe mbjelljen e tyre e vaditjen. Jane parashikuar materialet, transporti si dhe paga me gjithë shtesa e fitimin per te perfunduar punen.

F V stola gize per lulishte.

Parashikon transportin e furnizimin me stolat prej gize komplet me gjithë aksesoret si dhe fiksimin e tyre ne vendet e percaktuara. Jane parashikuar materialet, transporti si dhe paga me gjithë shtesa e fitimin per te perfunduar punen.

Nr 8 PUNIME TE SISTEMIMIT TE PERROIT.

a) Punime germimi toke e zakonshme ne prani uji

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te zakoneshme me krahe,ngarkimi dhe largimi I tij ne distance deri 30 ml.Jane parashikuar edhe punime shtese per largimin e ujrave.Ne shpenzimet jane parashikuar pagat me shtesat e tyre si dhe fitimi.

b) Punime germimi toke e forte me cekic e kompresor

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te forte me kompresor,ngarkimi dhe largimi I tij ne distance deri 30 ml.Pervec pagave me gjithë shtesat eshte parashikuar edhe vlefte e makinerise per kohen e punes si dhe fitimi.

c) Punime mbushje e ngjeshje dheu me tokmak

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per mbushje e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne project duke parashikuar sjelljen e materialit mbushes ne vendin e punes ,perhapjen e tij e ngjeshjen. Pervec pagave me gjithë shtesat eshte parashikuar edhe vlefte e makinerise per kohen e punes per afrimin e materialit si dhe fitimi i planifikuar.

d) Veshje skarpati me gure mozaik mbi 25 cm me beton C 20/30.

Eshte parashikuar vlera e furnizimit me beton e gure sipas te dhenave te projektit dhe vlera e puntorise se nevojeshme per realizimin e veshjes per 1 m²

Se bashku me shtesat e fitimin.

Themel ne veshje me butobeton me 25% gure

Eshte parashikuar vlera e furnizimit me beton e gure sipas te dhenave te projektit dhe vlera e puntorise se nevojeshme per realizimin e ndertimit per 1 m³ themeli se bashku me shtesat e fitimin.

g) Punime germimi toke e zakoneshme me krahe themel gabionash

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 simbas dimensioneve te dhena ne project per toke te zakoneshme me



krahe,ngarkimi dhe largimi I tij ne distance deri 30 ml. Ne shpenzimet jane parashikuar pagat me shtesat e tyre si dhe fitimi.

Germim dheu makineri me eskavator me zinxhire

Eshte parashikuar germimi i dherave dhe hedhja e tyre me makineri deri 30 ml largesi.Vlefte e punes eshte percaktuar duke patur parasysh normativat orare te makinerive te ndertimit me makineri eskavator me zinxhire per aresye te terrenit me kove deri 1 m³. Mbushje me dhe 40% e zhavorr e ngjeshje me shtresa

Eshte parashikuar germimi i dherave dhe hedhja e tyre me makineri deri 30 ml largesi.Eshte parashikuar edhe hedhja me makineri e shperndarja e tyre e ngjeshja e tyre ne shtresa 40 cm.Vlefte e punes eshte percaktuar duke patur parasysh normativat orare te makinerive te ndertimit me makineri eskavator me zinxhire per aresye te terrenit me kove deri 1 m³si dhe pagat e puntoreve qe bejne shperndarjen e ngjeshjen me shtesat mbi pagat dhe fitimin.

Mur guri me gabiona

Eshte llogaritur ndertimi mur guri te thate Brenda koshit (gabjonave) me gure kavo si dhe vlere e telit rrjete xingato me diametre 2.7 mm.

Eshte parashikuar vlefte e hekurit te nevojshem ashtu si eshte dhene ne project me gjithe shtesat e tjera si 3 % firo,tel bari I nevojshem (I zakonshem) per lidhje etj.Gjithashtu simbas normativave te dhena ne manualin e Ministrise Puneve Publike e Transportit eshte parashikuar edhe vlefte e nevojshme per pagat puntori megjithe shtesat.

k) Mur guri per prita llb m 50

Ne kete ze eshte parashikuar ndertimi mureve mbajtes e prites me llac bast m 30.Guret do te perdoren nga formacioni material vendi dhe eshte parashikuar te merren ne afersi me nje distance transporti 1 km.Llaci do te jete me pluhur guri ose rere e lare qe te realizohet marka e llacit 30 simbas normativave te KTZ ne fuqi.Vlefte e materialit dhe transportit eshte parashikuar

125

vecmas me shpenzimet per pagesat puntori dhe me shtesat perkatese.

l) Gure dekorative te gdhendur

Ne kete ze eshte parashikuar gdhendja e ashper ne 5 faqe .Guret do te perdoren nga formacioni material vendi dhe eshte parashikuar te merren ne afersi me nje distance transporti 1 km. qe do te zhyten ne beton .Vlefte e materialit dhe transportit eshte parashikuar vecmas me shpenzimet per pagesat puntori dhe me shtesat perkatese.

m) Kangjella metalike me hekur te punuar dekorative.

Parashikohet furnizimi me hekur katror,perpunimi i tij sipas projektit,dhe behet saldimi duke bere edhe saldimin me fitilat e lena ne beton,duke patur parasysh edhe materialet ndihmese sielektroda,energji dhe fuqia puntore me gjithë shtesat e fitimin per realizimin e tyre.

m) Gabjona me rrjete zingato diameter 2.7mm eskelet hekuri

Parashikohet furnizimi me hekur diameter 10 mm per berjen e skeletit,rrjete gabioni diameter 2.7 mm me perdredhje dyfishe e hapje ekzagonale,teli barit per qepje si dhe fuqia puntore me gjithë shtesat e fitimin per realizimin e tyre.

Nr 9 PUNIME NE VEPRA ARTI.

a) Punime germimi toke e forte ne prani uji

Ketu eshte parashikuar vlefte e shpenzimeve per germimin e 1 m³ simbas dimensioneve te dhena ne projekt per toke te forte me krah edhe makineri,ngarkimi dhe largimi i tij ne distance deri 30 ml.Jane parashikuar edhe punime shtese per largimin e ujrave.Ne shpenzimet jane parashikuar pagat me shtesat e tyre si dhe fitimi

b) Punime betoni ne shpatulla ,pilota,soleta C 25/30 etj

Betoni eshte parashikuar te merret ne nyje dhe hedhja e tij me mjete te mekanizuara.Eshte parashikuar ne baze te normativave ndertimi i skelave e kallepeve me lende druri,aksesoret e tjere si gozhe etj materiale te imta .Per ket arsye nevojat per puntori te logaritura me normativat ne fuqi jane parashikuar per ndertimin e



kallepeve dhe nivelimin apo edhe ngjeshjen t ij me vibrator si dhe mirembajtjen edhe zmontimin e skelerive e kallepit mbasi betoni te kete arritur marken e kerkuar ne projekt.Ne vleften puntori jane perfshire edhe shtesat e sigurimeve shoqerore.

c) FV hekur beton zakonshem.

Eshte parashikuar vlefte e hekurit te nevojshem ashtu si eshte dhene ne project me gjith shtesat e tjera si 3 % firo,tel bari I nevojshem (I zakonshem) per lidhje etj.Gjithashtu sambas normativave te dhena ne manualin e Ministrise Puneve Publike e Transportit eshte parashikuar edhe vlefte e nevojshme per pagat puntori megjithe shtesat.

b) Punime betoni ne shtresen mbrojtese te ures C 16/20

Betoni eshte parashikuar te merret ne nyje dhe hedhja e tij me mjete te mekanizuara.Eshte parashikuar hapja e nivelimi i tij simbas sqarimit ne project. .Per ket aresye nevojat per puntori te logaritura me normativat ne fuqi jane parashikuar per nivelimin apo edhe ngjeshjen t ij me vibrator si dhe mirembajtjen..Ne vleften puntori jane perfshire edhe shtesat e sigurimeve shoqerore

c) Shtrese asfaltobetoni $t=3$ cm

Ne kete ze cmimi eshte parashikuar vlefte kryesore e asfaltobetone per 1 m² ne baze te sasise qe I takon simbas normativave te materialit ne perputhje me manualin e hartuar per ket rast.Pervec vleftes si material jane parashikuar transporti nga nyja ne veper,perhapja me makine asfaltoshtuese simbas projektit dhe rulimi I tij ne baze te KTZ per punimet e asfaltimit.Eshte parashikuar edhe fuqia puntore e nevojshme pagat e shtesat.

AUTORET

Ing Llambi Tarka

Ing Koco Shedollari